



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 9 tetor 2017  
Nr. ref.: RK1137/17

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI127/16 dhe KI35/17**

Parashtrues

**Ndërmarrja Private Tregtare “Riar-Alfis”**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, IV. C. nr. 408/15, të 7 korrikut 2016, Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, GJA. nr. 1214/2016, të 25 korrikut 2016 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac. nr. 2685/17, të 31 janarit 2017**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i të dyja kërkesave KI127/16 dhe KI35/17 është Ndërmarrja Private Tregtare “Riar-Alfis” nga Prishtina, e përfaqësuar nga pronari Rifat Sadiku (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi në kërkesën KI127/16 konteston Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Ekonomike, IV. C. nr. 408/15, të 7 korrikut 2016 dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, GJA. nr. 1214/2016, të 25 korrikut 2016, i cili i është dorëzuar më 21 shtator 2016.
3. Parashtruesi në kërkesën KI35/17 konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 2685/17, të 31 janarit 2017 (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit).

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të kontestuara. Me këto vendime pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenet 6 [E drejta për një proces të rregullt], 13 [E drejta për zgjidhje efektive], 14 [Ndalimi i diskriminimit], 17 [Ndalimi i shpërdorimit të të drejtave], 18 [Kufiri i zbatueshmërisë së kufizimeve të të drejtave] dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 [Mbrojtja e pronës] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në nenet 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 4 nëntor 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën KI127/16 në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 5 dhjetor 2016, parashtruesi i kërkesës paraqiti dokumente shtesë lidhur me procedurën disiplinore ndaj gjyqtarit të çështjes, duke kërkuar që dokumentet shtesë t'i bashkohen kërkesës.
8. Më 14 dhjetor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.
9. Më 22 dhjetor 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës KI127/16 dhe dërgoi një kopje të kërkesës në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike.



10. Më 30 mars 2017, parashtruesi dorëzoi një kërkesë tjetër në Gjykatë, të regjistruar si kërkesa KI35/17.
11. Më 25 prill 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës KI35/17 dhe dërgoi një kopje të kërkesës në Gjykatën e Apelit.
12. Më 28 prill 2017, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesës KI35/17 me kërkesën KI127/16 në pajtim me rregullin 37 (1) të Rregullores së punës. Sipas Urdhrit, gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues në të dyja rastet (KI127/16 dhe KI35/17) mbesin të njëjtë, siç është vendosur me Vendimin nr. KSH. KI127/16.
13. Më 8 maj 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës, Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe Gjykatën e Apelit për bashkimin e lëndëve KI127/16 dhe KI35/17.
14. Më 5 shtator 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

15. Faktet në lidhje me të dy kërkesat kanë të bëjnë me të njëjtën seri të procedurave gjyqësore.

### **Procedura kontestimore**

16. Më 30 tetor 2008, parashtruesi i kërkesës lidhi kontratë me Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar “Interpress R. Company” (në tekstin e mëtejme: SHPK “Interpress R. Company”) në cilësinë e investitorit, për ndërtimin dhe renovimin e ish-hipermarketit “Voçar”.
17. Më 16 prill 2009, parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, duke kërkuar përmbushjen e detyrimeve kontraktuale. SHPK “Interpress R. Company” parashtrroi kundërpadi në të njëjtën gjykatë.
18. Më 7 shtator 2011, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin I. C. nr. 269/2009 aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit dhe e detyroi SHPK “Interpress R. Company” që në emër të borxhit për punët e kryera t’ia paguaj parashtruesit të kërkesës shumën prej 41.250,00 euro dhe kamatën prej 3.5% nga data e paraqitjes së padisë, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 2,532.00 euro.
19. Me të njëjtin aktgjykim, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit në lidhje me fitimin e humbur në shumë prej 87,986.25 euro, si dhe refuzoi edhe kundërpadinë e paraqitur nga SHPK “Interpress R. Company” në shumë prej 102,477.00 euro.
20. Të dyja palët ndërgjyqëse kanë paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, I. C. nr. 269/2009.

21. Më 9 tetor 2014, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin Ae. nr. 384/2012 pjesërisht e aprovoi ankesën e SHPK "Interpress R. Company" sa i përket shpenzimeve të procedurës dhe i zvogëloi shpenzimet e procedurës në 844.00 euro, ndërsa në pjesë të tjera e konfirmoi Aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, I. C. nr. 269/2009.
22. SHPK "Interpress R. Company" paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.
23. Më 19 gusht 2015, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin E. Rev. nr. 17/2015, aprovoi si të bazuar revizionin e të paditurës SHPK "Interpress R. Company", duke konkluduar se aktgjykimet e mëparshme janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore sepse e paditura është përfaqësuar nga personi i paautorizuar, duke urdhëruar që të:
 

*"... anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae. nr. 384/2012 datë 09.10.2014, dhe ai i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, C. nr. 269/2009 date 07.09.2011, dhe lënda kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë."*
24. Më 7 korrik 2016, në rigjykim, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike në seancën përgatitore nxori Aktvendimin IV. C. nr. 408/15, me të cilin aprovoi kërkesën e SHPK "Interpress R. Company", që të ndërpritet procedura në këtë procedurë kontestimore derisa të përfundohet procedura kundër përmbarimit sipas Aktvendimit E. nr. 1877/15, të 25 shkurtit 2016. Gjykata Themelore arsyetoi se procedura kundër përmbarimit është çështje paraprake e cila duhet të zgjidhet para se të vazhdojë procedura kontestimore.

### **Procedura përmbarimore dhe kundërpërmbarimore**

25. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ae. nr. 384/2012 inicioi procedurën e përmbarimit para përmbaruesit privat, pasi që kërkesa për revizion e paraqitur nga SHPK "Interpress R. Company" si mjet i jashtëzakonshëm juridik nuk e ndalon përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.
26. Përmbaruesi privat me Urdhrin për përmbarim P. nr. 19/15 lejoi përmbarimin në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ae. nr. 384/2012.
27. Më 20 nëntor 2015, SHPK "Interpress R. Company" paraqiti kërkesë për kundërpërmbarim, pasi që në bazë të kërkesës për revizion Gjykata Supreme me Aktvendimin E. Rev. nr. 17/2015 e anuloi "Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae. nr. 384/2012 datë 09.10.2014, dhe atë të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, C. nr. 269/2009 datë 07.09.2011".
28. Më 9 dhjetor 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Konkluzionin E nr. 1877/15 kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të deklarohet lidhur me kërkesën për kundërpërmbarim.



29. Më 11 janar 2016, parashtruesi i kërkesës paraqiti kundërshtim kundër propozimit për kundërpërmbarim.
30. Më 27 janar 2016, Gjkata Themelore në Prishtinë mbajti seancë dëgjimore lidhur me procedurën e kundërpërmbarimit.
31. Më 25 shkurt 2016, Gjkata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin E. nr. 1877/15 miratoi pjesërisht propozimin për kundërpërmbarim dhe e obligoi parashtruesin e kërkesës *“që t’ia kthej shumën prej 51,999.54€ të cilat i janë marrë kreditorit në bazë të procedurës së përmbarimit të zbatuar pranë përmbaruesit privat Isak Islami si organ përmbarues me kamat prej 8% nga dt:19.08.2015 deri në kthimin e mjeteve dhe, t’ia paguaj shumën prej 260.00€ në emër të shpenzimeve të procedurës përmbarimore, në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.”*
32. Më 25 shkurt 2016, Gjkata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin tjetër E nr. 1877/15 refuzoi kundërshtimin e debitorit të kundërpërmbarimit (parashtruesit të kërkesës) dhe vazhdoi procedurën e kundërpërmbarimit.
33. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kundërshtimin kundër të dyja aktvendimeve të Gjykatës Themelore në Prishtinë.
34. Më 9 qershor 2016, Gjkata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin E. nr. 1877/2015 refuzoi kundërshtimet e parashtruesit të kërkesës.
35. Parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit E. nr. 1877/2015, të 9 qershorit 2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë.
36. Më 31 janar 2017, Gjkata e Apelit me Aktvendimin Ac. nr. 2685/2016, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktvendimin E. nr. 1877/2015, të 9 qershorit 2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

### **Procedura për përjashtim të gjyqtarit dhe procedura disiplinore**

37. Më 11 korrik 2016, parashtruesi paraqiti kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit M. P. nga procedura dhe vendosje në rigjykim në procedurën kontestimore në Gjykatën Themelore në Prishtinë, me arsyetim se ai nxori:
 

*“... aktvendimin për ndërprerjen e procedurës në këtë çështje kontestimore të datës 07.07.2015, deri sa të përfundohet procedura e kundërpërmbarimit, i njëjti është në kundërshtim me dispozitat e nenit 277 dhe 278 të LPK-së, sepse me asnjë kusht të paraparë në këto dispozita nuk mund të justifikohet ligjshmëria e këtij aktvendimi.”*
38. Më 25 korrik 2016, Gjkata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin GJA. 1214/2016, refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për përjashtimin e gjyqtarit M. P. nga procedura.
39. Më 29 gusht 2016, parashtruesi parashtrroi kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore në Zyrën e Prokurorit Disiplinor kundër gjyqtarit M. P.

40. Më 7 nëntor 2016, Zyra e Prokurorit Disiplinor me shkresën ZPD/16/KB/892 e njoftoi parashtruesin e kërkesës se e kishte hapur hetimin disiplinor (i cili është në vazhdim e sipër) kundër gjyqtarit M. P., lidhur me mënyrën e procedimit në rastin e parashtruesit të kërkesës IV. C. nr. 408/2015.

### **Pretendimet e parashtruesit në të dyja kërkesat**

41. Pretendimet e parashtruesit në lidhje me të dy kërkesat janë në esencë identike. Në thelb, ai pretendon se janë shkelur të drejtat e tij për gjykim të drejtë dhe barazi të trajtimit para ligjit, sepse gjykatat e rregullta kanë lejuar që procedurat kundërpërmbartimore të kenë përparësi ndaj rigjyqimit për meritat e procedurës së kontestuar për kontestin themelor.
42. Në kërkesën KI127/16, parashtruesi veçanërisht pretendon se ky veprim i gjykatave të rregullta përbën shkelje të neneve 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
43. Në kërkesën KI35/17, parashtruesi i kërkesës i përsërit të njëjtat pretendime në lidhje me Kushtetutën dhe gjithashtu pretendon shkelje të neneve 6 [E drejta për një proces të rregullt], 13 [E drejta për zgjidhje efektive], 17 [Ndalimi i shpërdorimit të të drejtave], 18 [Kufiri i zbatueshmërisë së kufizimeve të të drejtave] dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 [Mbrojtja e pronës] të KEDNJ-së.
44. Si përmbledhje, parashtruesi i kërkesës konsideron se procedurat kundërpërmbartimore nuk janë çështje paraprake në lidhje me procedurën kontestimore, por se procedurat kontestimore janë një çështje paraprake në lidhje me procedurën e përmbartimit. Prandaj, parashtruesi pohon se procedurat e aplikuara nga gjykatat e rregullta janë në shkelje të ligjit dhe kjo e vendos parashtruesin në një pozitë të pabarabartë *vis-à-vis* palës së paditur.
45. Për shkak se procedurat kundërpërmbartimore vendosen së pari, parashtruesi i kërkesës pretendon se kjo shkel të drejtën e tij për një proces të rregullt për meritat e procedurës së tij kontestimore.
46. Për më tepër, për shkak se gjyqtari kishte vendosur që procedurat kontestimore ishin dytësore ndaj procedurave kundërpërmbartimore, në shkelje me ligjin, parashtruesi konsideron se kjo është dëshmi e anësisë ndaj tij nga ana e atij gjyqtari. Kërkesa e parashtruesit për përjashtimin e këtij gjyqtari ishte refuzuar, prandaj parashtruesi i kërkesës pretendon se ai nuk mund të marrë një gjykim të drejtë nga ky gjyqtar.
47. Në lidhje me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, IV. C. nr. 408/15, të 7 korrikut 2016, që pezullon procedurën kontestimore, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata:

*“... 3). Të ANULON Aktvendimin e dt. 07.07.2016 në lëndën kontestimore IV. C. nr. A08/15 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Ekonomik, me të cilin shkelet neni 24 pik. 1, neni 31, 32, 54 të Kushtetutës së Republikës të Kosovës si dhe, nenin 6 pik. 1 dhe 13 KEDNJ-së.*”



- 4). Të **URDHËRON** Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Ekonomik të filloj rigjykimin në lëndën kontestimore IV. C. nr. 40B/15 sipas aktvendimit Rev. nr. 17/2015 dat. 19.08.2015 të Gjykatës Supreme të Kosovës, në bazë të rregullit 74.1 të Rregullores së punës.
- 5) Të **URDHËRON** Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil - të ndërprejë procedurën e kundërpërmbarrimit sipas aktvendimit E. nr. 1877 /15 dat. 09.06.2016 deri sa të përfundon procedura kontestimore e rigjykimit me vendim të formës së prerë sipas aktvendimit E. Rev. nr. 17/2015 dat. 19.08.2015 të Gjykatës Supreme të Kosovës, Për shkak se procedura kontestimore është çështje paraprake e kontestit. Dhe me aktvendim E. nr. 1877/15 të dat. 09.06.2016 është shkelur neni 24 pik. 1, neni 31,32,54 të Kushtetutës së Republikës të Kosovës dhe, neni 6 dhe 13 KEDNJ -së.”
48. Në lidhje me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, GJA. nr. 1214/2016, të 25 korrikut 2016, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata:
- “..3). Të **ANULON** Aktvendimin GJA. nr. 1214/2016 dat. 25.07.2016, të Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti Ekonomik, i cili shkelë nenin 24 pik. 1, nenet 31,54 të Kushtetutës së Republikës të Kosovës si dhe, nenin 6 pik. 1 dhe 13 KEDNJ-së.
- 4). Të **APROVOHET** kërkesa e parashtruesit për përjashtimin e M. P. gjyqtar në Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Ekonomik nga procedimi dhe vendosja në çështjen juridike kontestimore IV. Ek. nr. 408/2015 si e **bazuar.**”
49. Lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 2685/17, të 31 janarit, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që:

“TË **ANULON** aktvendimin Ac. nr. 2685/16, me të cilin parashtruesit të kërkesës i shkaktohen dëme të pariparueshme.  
**TË VËRTETON** se me aktvendim, parashtruesit të kërkesës i janë shkelë të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës të përkufizuara në nenin 21 pika 1) 2) 3), nenin 24 pika 1), nenin 31, 46, 54, dhe dispozitat e KEDNJ-së të përkufizuara në nenin 6.1, 13, nenin 1 protokoll 1, si dhe nenet 14, 17, 18”.

[...]

### **Pranueshmëria e kërkesës**

50. Gjykata do të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
51. Së pari, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

- [...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
52. Pastaj Gjykata i referohet nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], paragrafi 4 i Kushtetutës, i cili parasheh që:
- “4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.*
53. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit, i cili përcakton se:
- “2. Individidi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*
54. Gjykata më tej i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh që:
- “Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*
55. Për më tepër, Gjykata merr parasysh rregullin 36 paragrafi 1 (b) dhe (d) dhe paragrafi 2 (a) të Rregullores së punës, i cili parasheh që:
- “1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*  
 [...]
 (b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar”.  
 [...]
 (d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.
- (2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*  
 (a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose [...]”.
56. Gjykata së pari konsideron se në pajtim me nenin 21.4 të Kushtetutës, i cili parashikon se *“të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”*, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të parashtrrojë ankesë kushtetuese, duke iu referuar të drejtave themelore të cilat janë të vlefshme, si për individët, ashtu edhe për personat juridikë, siç është parashtruesi i kërkesës (Shih Aktvendimi për papranueshmëri, AAB-RIINVEST Universiteti LLC, Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, KI41/09, të 21 janarit 2010).
57. Në rastin në fjalë, Gjykata konsideron se parashtruesi është palë e autorizuar dhe ka parashtruar kërkesën brenda afatit të caktuar. Megjithatë, Gjykata



duhet të vlerësojë më tej nëse janë plotësuar kriteret e parapara me nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe të parapara me rregullin 36 të Rregullores së punës.

58. Gjykata do të vlerësojë pretendimet kundër secilit prej tri vendimeve të kontestuara të gjykatave të rregullta veç e veç.

***A. Lidhur me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, IV. C. nr. 408/15, të 7 korrikut 2016***

59. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, IV. C. nr. 408/15, të 7 korrikut 2016, me të cilin ishte pezulluar procedura kontestimore, duke u bazuar në argumentin se ky vendim ishte në shkelje të ligjit, dhe në këtë mënyrë kishte shkelur të drejtat e tij për një gjykim të drejtë për meritat procedurës kontestimore.
60. Gjykata vëren se Gjykata Themelore pezulloi procedurën kontestimore në pritje të një vendimi lidhur me procedurën kundërpërmbartimore.
61. Si e tillë, Gjykata vëren se procedura kontestimore do të rifillojë pasi të jetë përfunduar procedura kundërpërmbartimore.
62. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që mund të pranoj vetëm kërkesat që parashtrohen pasi që parashtruesi i kërkesës t'i ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.
63. Arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike, si në këtë rast, është që t'u ofrojë gjykatave të rregullta mundësinë për ta korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjet efektiv juridik për shkeljen e të drejtave kushtetuese (Shih Aktvendimi për papranueshmërinë, *AAB-RIINVEST Universiteti LLC, Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, KI41/09, të 21 janarit 2010, dhe shih *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, Aktvendimi i 29 korrikut 1999).
64. Në rastin në fjalë, Gjykata vëren se vendimi i kontestuar është një përcaktim paraprak dhe se procedurat kontestimore do të vazhdojnë për meritat e të drejtave dhe detyrimeve të parashtruesve sapo të kenë përfunduar procedurat kundërpërmbartimore.
65. Gjykata rikujton që më 31 janar 2017, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin nr. 2685/2016, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, E. nr. 1877/2015, të 9 qershorit 2016 për procedurat kundërpërmbartimore.
66. Gjykata vëren se, rrjedhimisht, procedurat në Gjykatën Themelore për thelbin e kërkesave të parashtruesit tani mund të vazhdojnë.
67. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se procedurat janë në vazhdim dhe se rasti i parashtruesit të kërkesës nuk ka arritur ende një vendim të formës së prerë nga një gjykatë.

68. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit në lidhje me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë, IV. C. nr. 408/15 të 7 korrikut 2016, janë të parakohshme, sepse parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion me ligj.

***B. Lidhur me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, GJA. nr. 1214/2016, të 25 korrikut 2016***

69. Sa i përket vlerësimit të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, GJA. nr. 1214/2016, të 25 korrikut 2016, me të cilin ishte refuzuar kërkesa për përjashtimin e një gjyqtari, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se gjyqtari që kishte urdhëruar pezullimin e procedurës kontestimore ka qenë i anshëm ndaj parashtruesit.
70. Gjykata rikujton se kur është në pyetje paanësia e një gjyqtari, GJEDNJ ka identifikuar një provë subjektive, ku gjyqtari është personalisht i njëanshëm ndaj parashtruesit dhe një provë objektive.
71. Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ku thuhet se *“Sa i përket testit objektiv, Gjykata vëren që duhet të përcaktohet nëse, ka fakte të vërtetueshme që mund të ngrenë dyshime se a mundet një gjyqtar i caktuar të jetë i drejtë dhe i paanshëm në një rast të caktuar. Në këtë drejtim, mënyra se si duket diçka është e një rëndësie të caktuar. Në pyetje është besimi që gjykatat në një shoqëri demokratike duhet ta frymëzojnë në publik, dhe, mbi të gjitha, në të akuzuarin, i përket procedurave penale. Si rrjedhojë, cilido gjyqtar për të cilin ka arsye legjitime për të pasur frikë për mungesë të paanshmërisë duhet të tërhiqet (shih Aktgjykimi 24 majit 1989, Hauschildt kundër Danimarkës, nr. 10486/83, paragrafi 48).”*
72. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesë për procedurë disiplinore ndaj gjyqtarit të kontestuar.
73. Gjykata më tej vëren se lidhur me këtë ankesë disiplinore, Zyra e Prokurorit Disiplinor (shkresa ZPD/16/kb/892) e njoftoi parashtruesin se kishte iniciuar një hetim disiplinor kundër gjyqtarit të kontestuar lidhur me mënyrën e trajtimit të çështjes së parashtruesit. Gjykata vëren se ky hetim disiplinor është ende në vazhdim.
74. Si i tillë, Gjykata konsideron se çështja e njëanshmërisë së mundshme të gjyqtarit të kontestuar ende nuk është përcaktuar nga autoriteti kompetent.
75. Gjykata vëren se, sapo të jenë përfunduar këto procedura disiplinore, do të mbetet e hapur për parashtruesin e kërkesës që të kontestojë vendimet e këtij gjyqtari për arsye të animit, për shkak të mënyrës së trajtimit të procedurës kontestimore.
76. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se procedurat lidhur me çështjen themelore të paanshmërisë së gjyqtarit nuk kanë arritur ende një vendim të formës së prerë nga një gjykatë.



77. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit në lidhje me vendimin e kontestuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë, GJA. nr. 1214/2016, të 25 korrikut 2016 janë të parakohshme, sepse parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit.

***C. Lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 2685/17, të 31 janarit 2017.***

78. Lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 2685/17, të 31 janarit 2017, me të cilin lejohet procedura e kundërpërmbartimit, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se kjo bazohet në zbatimin e gabuar të ligjit dhe i shkakton dëme të pariparueshme.
79. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit ka bërë *“interpretimin e gabuar gjuhësor dhe juridik”* të nenit 54 paragrafi 1.1 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore.
80. Gjykata rikujton se Gjykata e Apelit arsyetoi vendimet e saj lidhur me këtë, duke deklaruar:

*“... Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejt faktin se janë plotësuar kushtet për caktimin e kundër përmbartimit sipas nenit 54 par. 1 dhe pika 1.1 të LPP-së, me të cilin parashihet se: Debitori ka të drejtë që në të njëjtën procedurë përmbartimore edhe pasi të ketë përfunduar përmbartimi, të kërkojë nga Gjykata nxjerrjen e aktvendimit me të cilin i urdhërohet kreditorit që t’ia kthejë atë që e ka marrë në bazë të procedurës së përmbartimit, në qoftë se: 1.1. dokumenti përmbartues me anë të vendimit të formës së prerë është prishur, ndryshuar, anuluar, shfuqizuar, ose në ndonjë mënyrë tjetër është konstatuar se është i pa efekt juridik, e që në rastin konkret, me Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 17/2015 të datës 19.08.2015 dokumenti përmbartues - Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac. nr. 384/2012 i dt. 09.10.2014 mbi bazën e të cilit është zbatuar përmbartimi pranë përmbartuesit privat janë anuluar nga Gjykata Supreme”.*

81. Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit, që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave ose zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë pretendim të arsyetuar dhe argument bindës me rastin e pohimit se autoriteti publik i ka cenuar të drejtat dhe liritë e tij të mbrojtura me Kushtetutë.
82. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës kishte mundësinë t’i paraqesë në gjykatat e rregullta argumentet faktike dhe ligjore lidhur me rastin në gjykatat e rregullta. Argumentet e tij janë dëgjuar dhe shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga ana e gjykatave të rregullta, dhe procedurat si tërësi ishin të drejta, si dhe vendimet e marra ishin të arsyetuara mirë.

83. Gjykata konsideron se fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me vendimet e gjykatave të rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih: *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
84. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se ka pasur shkelje të të drejtave të tij kushtetuese, por ai nuk ka paraqitur asnjë dëshmi *prima facie*, që do të tregonte se si janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese (Shih, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 31 majit 2005, *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë* nr. 53363/99).
85. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në çfarëdo mënyre kanë qenë të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06).
86. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimi i parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 2685/17 të 31 janarit 2017 është i papranueshëm, si qartazi i pabazuar në baza kushtetuese.

## **Përfundim**

87. Lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, IV. C. nr. 408/15, të 7 korrikut 2016 dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, GJA. nr. 1214/2016 të 25 korrikut 2016, Gjykata konkludon se procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë përfunduar.
88. Prandaj, pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me këto dy vendime janë të parakohshme dhe duhet të refuzohen si të papranueshme në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, sepse parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj që të jetë në gjendje të paraqesë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.
89. Lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit Ac. nr. 2685/17, të 31 janarit 2017 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij.
90. Prandaj, pretendimet e parashtruesit të kërkesës duhet të refuzohen si të papranueshme, si qartazi të pabazuara në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) (a) të Rregullores së punës, sepse parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie* e cila do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese.



## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenet 21 dhe 113 të Kushtetutës, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (b) dhe 36 (2) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 5 shtator 2017, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtarja raportuese



Snezhana Botusharova



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi